



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE LIGJORE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. 7075 prot.

Kamëz, më 26 . 8 .2024

RINOVIM KONTRATE QIRAJE

Sot, më datë 26 . 8 .2024, në Kamëz, palët e mëposhtme ranë dakord për të nënshkruar këtë rinovim kontrate, në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë, mbështetur në dispozitat e Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 801 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë; Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 163, datë 21.12.2022 “Mbi miratimin e detajimit të buxhetit për vitet 2023, 2024, 2025”; si dhe Kontratës së mëparshme nr. 7569 prot., datë 26.08.2022 të lidhur ndërmjet palëve kontraktore Bashkisë Kamëz dhe subjekti “Petrit Syla”.

BASHKIA KAMËZ, përfaqësuar nga **Znj. Rebeka SULEJMANI** – Zv. Kryetar i Bashkisë Kamëz, me seli në adresën: Bulevardi “Nënë Tereza”, nr. 492, që më poshtë do të quhet **“QIRADHËNËSI”**.

dhe

SUBJEKTI “PETRIT SYLA”, me seli qendrore në Kamëz, me adresë: Qendër Kamëz, regjistruar si person fizik dhe pajisur nga QKB-ja, me NIPT: L91609024Q, përfaqësuar nga **z. Petrit Syla**, i biri i _____, i datëlindjes _____ lindur në _____ dhe banues në Kamëz, me shtetësi shqiptare, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal: _____, që më poshtë do të quhet **“QIRAMARRËSI”**.

NENI 1 OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e pasurisë shtetërore: “Ambiente brenda Pallatit të Kulturës të llojit “Ndërtesë”, “pjesa e nëndheshme”, me sipërfaqe 101,4 (njëqind e një presje katër) m² në përgjegjësi administrimi të Bashkisë Kamëz, sipas genplanit, bashkëlidhur kontratës.

NENI 2 AFATI I KONTRATËS

Kontrata fillestare me nr. 7569 prot., datë 26.08.2022, e rinovur me kontratën nr. 6588 prot., datë 08.09.2023, me afat vlefshmërie deri më 25.08.2024, rinovohet për një periudhë 1 (një) vjeçare, deri më datë 25.08.2025.

NENI 3
VLERA E KONTRATËS

Vlera totale e qirasë e përcaktuar në kontratën e mëparshme nuk ndryshon me nënshkrimin e rinovimit të kontratës. “Qiramarrësi” detyrohet t’i paguajë “Qiradhënësit” detyrimin mujor të kontratës, për 101,4 (njëqind e një presje katër) m² në vlerën 300 (treqind) lekë për m² (metër katror).


NENI 4
PJESËT INTEGRALE TË KONTRATËS

Pjesë integrale e kësaj kontrate do të jenë të gjitha përcaktimet e tjera të specifikuar në kontratën fillestare nr. 7569 prot., datë 26.08.2022 (*Rinovimi i kontratës është pjesë e pandashme e kontratës së mëparshme*).

Kjo kontratë u hartua në gjuhën shqipe, në 4 (katër) kopje, të cilat u nënshkruan me vullnetin e plotë e të lirë të palëve.

QIRAMARRËSI
“PETRIT SYLA” PERSON FIZIK
PËRFAQËSUAR NGA ADMINISTRATORI

Petrÿt SYLA



QIRADHËNËSI
BASHKIA KAMËZ
Rakip SULI
ME URDHËR DHE DELEGIM
ZV. KRYETAR
Rebeka SULEJMANI

